



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ___/___/2022

V E N D I M

Nr. 30, datë 20/01/2022

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 147, datë 03.08.2021, e z. Y.R., ku pretendohet diskriminim për shkak të “etnisë”², nga ana e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (I.E.V.P.), Berat.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi³,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas informacionit të dhënë në ankesë, z. Y.R. pretendon se punon prej 6 vitesh pranë I.E.V.P. Berat, në pozicionin e punonjësit të policisë së rolit bazë. Ankuesi sqaron se në datën 31.05.2021 është transferuar në I.E.V.P. Fier dhe shprehet se ky transferim është kryer pa dëshirën e tij. Ai sqaron se ka punonjës të tjerë policie, që mund të transferoheshin në vendin e tij, pasi kanë vlerësim më të ulët pune, si dhe vendbanimi i tyre është më afër qytetit të Fierit. Z. Y.R. pretendon se është diskriminuar nga ana e I.E.V.P. Berat, pasi ai i përket komunitetit egjiptian.

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD;

² Referuar Vërtetimit nr. 421, datë 24.07.2021, të Shoqatës “Egjiptianët e Bashkuar të Shqipërisë” rezulton se z. Ymer Y.R. i përket komunitetit egjiptian.

³ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD;

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën e sipërcituar, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”⁴, të ndryshuar, që i atribuon të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të “etnisë”, duke përcaktuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Neni 7, i LMD, i ndryshuar, parashikon shprehimisht: “1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim. 2. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. 3. Autoritetet publike kanë detyrimin për të promovuar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.”

Në Kreun III, të ligjit të sipërcituar parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Ky ligj në nenin 12, pika 1, gërmat a) dhe b) parashikon shprehimisht se: “1. Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: a) shpalljen e vendeve të lira të punës; b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve, trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose

⁴ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës;”

Hapat procedurialë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Pas analizimit të ankesës nr. 147, datë 03.08.2021, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7⁵, të ligjit nr. 10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua I.E.V.P. Berat dhe për dijeni Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, I.E.V.P. Fier dhe ankuesit, me shkresën nr. 1163/1 prot., datë 05.08.2021, ku kërkohej informacion, si më poshtë vijon:
- Informacion i përgjithshëm mbi pretendimet e ankuesit;
 - Kopje e aktit të emërimit në detyrë dhe librezës së punës së ankuesit;
 - Kopje e shkresës së Drejtorit të I.E.V.P. Berat drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, nëpërmjet së cilës propozohet transferimi i ankuesit;
 - Kopje e aktit të transferimit të ankuesit si punonjës policie pranë I.E.V.P. Fier;
 - Informacion mbi arsyet e transferimit të ankuesit si punonjës policie pranë I.E.V.P. Fier;
 - Kriteret që duhen përmbushur nga punonjësit e policisë për t’u transferuar nga një I.E.V.P. në tjetrën;
 - Akti, nëpërmjet së cilit, ankuesi jep pëlqimin e tij për transferim si punonjës policie pranë I.E.V.P. Fier;
 - Informacion nëse ndaj ankuesit janë dhënë masa disiplinore përgjatë periudhës kohore, që ka punuar pranë I.E.V.P. Berat. Nëse po, të dërgohen praktikat përkatëse;
 - Informacion mbi vlerësimet në punë të ankuesit përgjatë periudhës kohore, që ai ka punuar pranë I.E.V.P. Berat;
 - Informacion mbi numrin e punonjësve të policisë, të rolit bazë, të I.E.V.P. Berat. Sa prej tyre i përkasin pakicës egjiptiane?

⁵ Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: *“Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”*.

- Numri i përgjithshëm i punonjësve të policisë, të rolit bazë, pranë I.E.V.P. Berat, që janë transferuar në I.E.V.P. të tjera përgjatë viteve 2018-2021 (informacioni të jepet i specifikuar për secilin vit). Sa prej tyre i përkasin mazhorancës dhe sa prej tyre i përkasin komunitetit egjiptian?
 - Numri i pozicioneve vakante, për policinë e rolit bazë, pranë I.E.V.P. Berat;
 - Informacion mbi punonjësin (kopje e dosjes personale), që ka zëvendësuar ankuesin;
- I.E.V.P. Berat nuk i dërgoi përgjigje shkresës nr. 1163/1 prot., datë 05.08.2021, së Komisionerit.
- Në përgjigje të shkresës nr. 1163/1 prot., datë 05.08.2021, së KMD-së, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dërgoi shkresën nr. 8459/3, datë 24.08.2021, nëpërmjet së cilës informon se pretendimi i ankuesit nuk është i mbështetur dhe nuk ekzistojnë veprime diskriminuese ndaj tij.

Në shkresë sqarohet se mbështetur në Urdhrin nr. 43, datë 25.03.2021, e Kryeministrit, “*Për miratimin e strukturës e të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe sistemit të institucioneve në varësi të saj*” sistemi penitenciar i është nënshtruar një procesi gjithpërfshirës ristrukturimi, i cili është shoqëruar me mjaft ndryshime organike dhe rialokime asetesh njerëzore sipas nevojave të identifikuara e të vlerësuara në sistem.

Në kuadër të kësaj strukture në I.E.V.P. Penale Berat janë shkurtuar 4 pozicione pune “*punonjës policie të rolit bazë*” dhe pas implementimit të strukturës janë larguar 4 punonjës, të cilët janë sistemuar në punë në të njëjtën mënyrë dhe në të njëjtat pozicione pune, sikurse ankuesi, pranë I.E.V.P. Fier. Punonjësit e transferuar janë z. P.S., z. SH.Sh., znj. L.R. dhe ankuesi Y.R..

Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve sqaron se është në fokusin e këtij institucioni, që të vlerësojë me shumë kujdes që stafi që shërben në burgje të ndihet plotësisht i dëgjuar, i mbështetur dhe i vlerësuar për cilësitë profesionale dhe ato personale të manifestuara në vendin e punës. Lidhur me rastin konkret, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve sqaron se ka kryer të gjithë verifikimet e nevojshme, nga ku ka rezultuar se z. Y.R. ka ushtruar detyrën si punonjës i rolit bazë pranë I.E.V.P. Penale Berat nga viti 2015, deri në datën 02.06.2021 e më tej është transferuar me detyrë në I.E.V.P. Fier. Ankuesi është banor në qytetin e Kuçovës. Komisioni i ristrukturimit të I.E.V.P. Berat ka vënë në dijeni punonjësit e stafit me uniformë, lidhur me shkurtimin organik të pozicioneve të punës dhe mundësinë e sistemimit të tyre në një I.E.V.P. më afër vendbanimit. Kriteri bazik për përzgjedhjen e punonjësve që do të transferohen ka qenë kryesisht distanca e vendbanimit të punonjësve me I.E.V.P., në të cilën do të transferoheshin, sikurse edhe vlerësimi, masat disiplinore nëse do të kishte të tilla, si dhe arsye të veçanta. Nga shqyrtimi i këtyre kriterëve është vendosur transferimi në I.E.V.P. Penale Fier i 4 (katër) punonjësve të rolit bazë, ku ndër ta ishte edhe ankuesi Y.R..

Lidhur me arsyet e përzgjedhjes së ankuesit, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve sqaron se punonjësi Y.R. është vlerësuar me 65 pikë në instrumentin “Raport i Vlerësimit Vjetor të Punës së Punonjësve të Policisë” dhe distanca ndërmjet vendbanimit të tij dhe I.E.V.P. Fier është 39 km. Punonjësit që ishin vlerësuar me pikavarazh më të ulët ose të njëjtë me ankuesin, kishin distancë më të largët (jashtë kriterit – më pak se 45 km) të vendbanimit të tyre nga I.E.V.P. Penale Fier, në krahasim me z. Y.R.. Disa prej tyre kishin një distancë më të madhe se 45 km, ndërmjet vendbanimit dhe I.E.V.P. Fier.

Për sa më sipër, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve sqaron se janë dy punonjës të rolit bazë, të cilët kanë të njëjtin pikavarazh vlerësimi në punë me ankuesin dhe distancë më të shkurtër vendbanimi me I.E.V.P. Fier se ankuesi, për të cilët u vendos mostransferimi i tyre. Këta punonjës janë z. P.C. dhe z. G.Z. Arsyet e mostransferimit të tyre konsistojnë në faktin se z. P.C., i cili është në moshën 60 vjeç, u gjykua të mos transferohej për shkak të moshës së tij, pavarësisht se vlerësimi i tij në punë është i njëjtë me atë të ankuesit. Këtu, përmendet fakti se punonjësi Y.R. është ndërkohë për moskonformitet në detyrë në dy raste, ndërsa punonjësi P.C. vetëm në një rast. Njëkohësisht, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve vë në dukje faktin se punonjësi tjetër, z. G.Z. nuk u tranferua për arsye të veçanta. Arsyeja e veçantë që u mor në vlerësim konsiston në faktin se ky punonjës ka një fëmijë të diagnostikuar me “çrregullim të spektrit të autizmit të shoqëruar me epilepsi”.

Për sa i përket kriterëve që duhen plotësuar nga ana e punonjësve të policisë për t’u tranferuar nga një I.E.V.P. në tjerën, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve sqaron se nuk ka kriterë të përcaktuara për transferim të punonjësve nga një I.E.V.P. në një tjetër, përveçse kriteri ndalues që nuk mund të transferohen përtej 45 km larg vendbanimit.⁶ Përzgjedhja e punonjësve për transferime, brenda kriterit prej 45 km kryhet në varësi të nevojave të institucionit, me qëllim fuqizimin e përmirësimit të shërbimeve sipas kërkesave të nenit 34 të ligjit nr. 80/2020 “Për Policinë e Burgjeve”.

Referuar sërish të njëjtës dispozitë, transferimi i punonjësit të Policisë së Burgjeve kryhet nga Drejtori i Përgjithshëm, me propozim të Drejtorit të Policisë së Burgjeve, vetëm për nevoja dhe interes të punës. Sipas këtij parashikimi përcaktohet se transferimi i punonjësit të policisë si rregull bëhet me pëlqim të punonjësit, por transferimi i tij nuk kushtëzohet nga pëlqimi ose jo i tij. Referuar organikës së re të I.E.V.P. Berat, ankuesi dhe 3 punonjësit e tjerë mund të liroheshin nga detyra, për shkak të shkurtimit të funksionit organik. Në kushtet kur, I.E.V.P. Fier kishte nevojë për rekrutim punonjësish të rinj, u vendos që për interes të punës, të katër punonjësit e I.E.V.P. Berat të transferoheshin në Fier.

Në bazë të pikës 3, të nenit 34, të ligjit nr. 80/2020 “Për Policinë e Burgjeve”, punonjësi ka ushtruar të drejtën e ankimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

⁶ Referuar nenit 34 të ligjit nr. 80/2020 “Për Policinë e Burgjeve”.

Në vlerësim të ankimit, sidomos pretendimit se transferimi i tij është kryer si sjellje diskriminuese për shkak të etnisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, pas kryerjes së verifikimeve të hollësishme të praktikave të transferimit në I.E.V.P. Berat, ka zhvilluar seancë dëgjimore me punonjësën, duke e sqaruar përsëri për procedurën dhe kriteret. Pas kësaj, ky punonjës është ankuar në datën 11.06.2021 edhe në Zyrën e Bashkëqeverisjes, së cilës Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve i është përgjigjur në rrugë elektronike me e-mail.

Lidhur me masat disiplinore të dhëna për ankuesin, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve sqaron se gjatë periudhës kohore që ankuesi ka ushtruar detyrën pranë I.E.V.P. Berat është ndërkohësisht me dy masa disiplinore (aktualisht të shuara) nga Komisioni Disiplinor pranë këtij institucioni. Këto masa kanë qenë: 1- Vërejtje me shkrim, për shkeljen e rregullave të shërbimit, dhënë nëpërmjet shkresës nr. 3494/2 prot., datë 30.08.2019, të Drejtorit të I.E.V.P. Berat dhe 2-vërejtje me paralajmërim, me të njëjtin motivacion si në masën e parë, dhënë nëpërmjet shkresës nr. 185, datë 20.01.2020, të Drejtorit të I.E.V.P. Berat.

Lidhur me numrin e punonjësve të rolit bazë pranë I.E.V.P.-së Berat që i përkasin pakicës egjiptiane, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve sqaron se ndër 11 punonjës të rolit bazë, përmes vetëdeklarimit, janë evidentuar 3 punonjës që i përkasin pakicës egjiptiane. Në harkun kohor 2018-2021 janë kryer vetëm 4 (katër) transferimet e sipërcituara, ndër të cilët 3 (tre) punonjës i përkasin mazhorancës. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve sqaron gjithashtu se pranë I.E.V.P. Berat nuk ka asnjë pozicion vakant për punonjësën e rolit bazë dhe se punonjësi Y.R. nuk është zëvendësuar nga asnjë punonjës tjetër, pasi pozicioni i tij është shkurtuar në organikë.

Në përfundim të shkresës së saj, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve thekson faktin se procesi i transferimit ka qenë plotësisht i rregullt e transparent, si dhe punonjësi është pritur dhe sqaruar hollësisht, lidhur me pretendimet e tij. Në këto kushte, ky institucion thekson faktin se krijohet dyshimi që ankesat e tij për diskriminim janë tërësisht të pabazuara, janë abuzive dhe tregues të një qasjeje viktimizuese, pa asnjë bazë reale, por vetëm për të përfituar diçka që nuk i takon. Në vijimësi, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve sqaron se do ta ketë në vëmendje rastin e ankuesit, që nëse do të krijohen vakanca për pozicionin e tij të punës, do ta vlerësojë mundësinë për ta rikthyer sërish atë me detyrë në I.E.V.P. Berat.

- Nëpërmjet shkresës nr. Y-5/4 prot., datë 23.08.2021, Ministria e Drejtësisë i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe I.E.V.P. Berat, si dhe për dijeni Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe ankuesit, ku kërkon informacion mbi ankesën e z. Y.R. Ministria e Drejtësisë kërkon nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe I.E.V.P. Berat të ketë në konsideratë rastin në fjalë dhe të dërgojë një përgjigje sa më të shpejtë, lidhur me pretendimin e ankuesit në adresë të KMD-së, si dhe ta mbajë të informuar edhe vetë Ministrinë e Drejtësisë. Njëkohësisht, ky institucion vë theksin në faktin se edhe më

herët, nëpërmjet shkresës Y-5/1 prot., datë 18.06.2021, ka përcjellë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, për verifikim dhe trajtim rastin e sipërcituar, duke mbajtur në konsideratë parashikimet e legjislacionit në fuqi, ndërkohë që nuk ka patur përgjigje lidhur me këtë rast.

- Në vijim të procedurave hetimore, nëpërmjet shkresës nr. 1163/4, datë 15.10.2021, së KMD-së, palët u njoftuan për seancë dëgjimore, e cila u vendos të realizohet në datën 28.10.2021, ora 11:00, pranë Zyrës së KMD-së.

Në seancë dëgjimore u paraqit përfaqësuesi i I.E.V.P. Berat, ndërkohë që ankuesi nuk u paraqit në seancë dëgjimore. Përfaqësuesi i këtij institucioni sqaroi se me Urdhrin nr. 43/2021, e Kryeministrit, është miratuar organika e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe institucioneve të varësisë. Nëpërmjet këtij udhëri është ndryshuar edhe struktura organike e I.E.V.P. Berat. Në vijim, është miratuar Urdhëri nr. 3512/1 datë 29.04.2021, i Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve nëpërmjet së cilit urdhërohet ngritja e komisioneve për zbatimin e strukturave të reja organike të I.E.V.P.-ve. Në zbatim të tij, u miratua Urdhëri nr. 1704, datë 04.05.2021, i Drejtorit të I.E.V.P. Berat, për ngritjen e komisionit përkatës, i cili do të merrej me zbatimin e strukturës së re të I.E.V.P.-së. Ky komision kryesohej nga Drejtori i I.E.V.P.-së. Lidhur me stafin me uniformë vlen të theksohet fakti se janë suprimuar 4 pozicione pune, 2 pozicione në regjimin e jashtëm dhe 2 pozicione në regjimin e brendshëm. Nga 115 punonjës me uniformë që parashikoheshin me strukturën e mëparshme, me strukturën aktuale mbeteshin 111 punonjës. Në kushtet kur, këto 4 vende do të shkurtoheshin dhe si rregull punonjësit respektiv do të liroheshin nga detyra, I.E.V.P. Berat kontaktoi me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, ku u ra dakord që këta punonjës që dilnin jashtë strukturës të transferoheshin pranë I.E.V.P. Fier, ku kishte vende vakante. Fillimisht, strukturat drejtuese të I.E.V.P. Berat iu drejtuan vartësve të tyre, duke i pyetur nëse dikush kishte dëshirë të transferohej pranë I.E.V.P. Fier duke patur si kriter kufizues, faktin që largësia ndërmjet vendbanimit të punonjësit dhe I.E.V.P. Fier të mos ishte më shumë se 45 km. Në kushtet kur, nuk pati asnjë punonjës që të shprehte dëshirën për transferim, atëherë komisioni përkatës kreu shqyrtimet përkatëse dhe propozoi 4 punonjësit që do të transferoheshin për në I.E.V.P. Fier. Këta punonjës ishin M. R. (femër), SH.Sh, P.S. dhe Y.R..Vendbanimi i tyre ishte më pak se 45 km nga I.E.V.P. Fier. Kishte edhe punonjës të tjerë që vendbanimin e tyre e kishin më pak se 45 km nga I.E.V.P. Fier, por nuk u transferuan pasi për ta u morën parasysh kriteret e veçanta. Kështu, për rastin e z. G.Z. u mor parasysh fakti se ka një fëmijë që vuan nga autizmi. I pyetur se mbi cilat kriteret vendosi komisioni përkatës për përzgjedhjen e punonjësve që të transferoheshin, përfaqësuesi i I.E.V.P. Fier u shpreh se kriter ndalues ishte vetëm largësia mbi 45 km. Kriteret e tjera ishin vlerësimi i punës, mosha, etj. I pyetur se ku ishin të përcaktuara kriteret e tilla, përfaqësuesi i I.E.V.P. Berat u shpreh se këto kriteret nuk ishin të parashikuara diku. Ligji i Policisë së Burgjeve njihet kompetencën e Drejtorit të Përgjithshëm për të kryer transferimin e punonjësve. Përfaqësuesit e KMD kërkuar informacion mbi procedurën e përzgjedhjes së 4 punonjësve që u

transferuan pranë I.E.V.P. Fier. Komisioni mori në shqyrtim vetëm punonjësit që e kishin vendbanimin nën 45 km me I.E.V.P. Fier, të cilit mund të ishin 7 ose 8 të tillë. Përfaqësuesi i I.E.V.P. Berat u pyet nga përfaqësuesit e KMD-së mbi faktin se përse performanca në punë e punonjësve duhet të konsiderohej kriter vlerësues për transferimin dhe cili është qëllimi i një vlerësimi të tillë. Njëkohësisht, ai u pyet edhe mbi të dhëna që kishin të bënin me numrin e punonjësve të rolit bazë, largësinë e vendbanimit të tyre nga I.E.V.P. Fier, kriteret e veçanta që ata kishin, masat disiplinore dhe performancën në punë të gjithësecilit. Mes palëve u ra dakord që informacioni i kërkuar nga përfaqësuesit e KMD-së do të dërgohej në vijim të seancës dëgjimore.

- Në vijim të seancës dëgjimore, I.E.V.P. Berat dërgoi me e-mail elektronikisht informacion, nëpërmjet shkresës nr. 2193 prot., datë 05.11.2021, bashkëlidhur së cilës është përcjellë edhe tabela me të dhënat e kërkuara gjatë seancës dëgjimore

Sipas informacionit të dërguar, I.E.V.P. Berat sqaron se në zbatim të Urdhërit të Kryeministrit nr. 43, datë 25.03.2021 *“Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe sistemit të institucioneve të varësi të saj”*, Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve ka nxjerrë Urdhrin nr. 3512/1, datë 29.04.2021 *“Për zbatimin e Urdhërit të Kryeministrit për zbatimin e strukturës organike nr. 43, datë 25.03.2021”*.

Në vijim në I.E.V.P. Berat u miratua Urdhëri nr. 1704, datë 04.05.2021, i Drejtorit të I.E.V.P. Berat *“Mbi ngritjen e komisionit për zbatimin e strukturës organike të I.E.V.P. Berat”*. Nga analiza e strukturës organike rezultoi se në I.E.V.P. Berat ishin shkurtuar 4 pozicione pune për punonjësit e rolit bazë, konkretisht 2 pozicione në Regjimin e Jashtëm dhe 2 pozicione në Regjimin e Brendshëm. Duke qënë se në I.E.V.P. Fier kishte vende vakante, u mendua që këta 4 punonjës të transferoheshin në këtë institucion. Fillimisht të gjithë punonjësit e Regjimit të Jashtëm dhe Regjimit të Brendshëm u informuan për këtë fakt dhe iu kërkua se kush shprehte dëshirën për t’u transferuar në I.E.V.P. Fier. Përveç punonjësës L.R., që ishte në Regjimin e Jashtëm, asnjë punonjës tjetër nuk dëshironte të transferohej. Ndodhur në këto kushte, i takonte Komisionit, përzgjedhja e tre punonjësve që do të transferoheshin, përkatësisht 1 punonjës nga Regjimi i Jashtëm dhe 2 punonjës nga Regjimi i Brendshëm. Në nenin 34 të ligjit nr. 80/2020 *“Për Policinë e Burgjeve”* është parashikuar se transferimi mund të bëhet nga Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, me propozim të Drejtorit të Policisë së Burgjeve, vetëm për nevoja dhe në interes të punës. Transferimi bëhet si rregull, me pëlqimin e punonjësit dhe nuk lejohet transferimi për punonjësit e rolit bazë mbi 45 km nga vendbanimi.

Përveç kriterit ndalues për punonjësit me mbi 45 km distancë, nuk parashikohet asnjë kriter tjetër në lidhje me transferimin. Në interpretim të këtij neni, kushdo mund të transferohej për nevoja dhe në interes të punës, nëse vendbanimi nuk është më larg se 45 km nga vendi i punës. Deri në momentin e hyrjes në fuqi të urdhërit të Kryeministrit nr.43, datë 25.03.2021, në I.E.V.P. Berat kanë qenë 106 punonjës të rolit bazë, konkretisht 23 punonjës të emëruar në Grupin e Sigurisë dhe

Shoqërimëve, 45 punonjës të emëruar në Regjimin e Brendshëm dhe 38 punonjës të emëruar në Regjimin e Jashtëm. Grupi i Sigurisë dhe Shoqërimëve nuk ndryshonte, ndërsa Regjimi i Brendshëm nga 45 punonjës bëhej me 43 të tillë dhe Regjimi i Jashtëm nga 38 punonjës bëhej me 36 të tillë. Përveç punonjësës L.R. që kishte shprehur vetë dëshirën për t'u transferuar, detyra e Komisionit të I.E.V.P. Berat ishte përzgjedhja e 3 punonjësve të tjerë, 1 nga Regjimi i Jashtëm dhe 2 nga Regjimi i Brendshëm. Në shqyrtimin e kandidaturave, fillimisht u përjashtuan punonjësit me vendbanim mbi 45 km nga I.E.V.P. Fier, nga ku rezultuan se 11 punonjës nga Regjimi i Brendshëm ishin me distancë nën 45 km nga vendbanimi dhe secili prej tyre mund të transferohej. Nga ana e Komisionit u përzgjedhën nga Regjimi i Brendshëm punonjësit P.S. (me distancë 42 km) dhe Y.R. (me distancë 40 km), ndërsa nga Regjimi i Jashtëm, punonjësi SH.Sh. (me distancë 40 km). Të ndodhur para faktit që duhej të përzgjidheshin 3 kandidatura për transferim dhe përveç kriterit ndalues nuk kishte asnjë kriter tjetër ku të bazoheshin, I.E.V.P. Berat sqaron se Komisioni vlerësoi bashkërisht distancën nga vendbanimi, performancën në punë dhe arsyet e veçanta, që kishin të bënin me moshën, me gjendjen familjare, me faktin që një punonjës ishte transferuar disa herë më parë etj. Sipas shkresës së I.E.V.P. Berat, aktualisht pranë këtij institucioni punojnë 3 punonjës që i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian, përkatësisht M.C., T.H. dhe K.K.

Bashkëlidhur shkresës është dërguar tabela me të dhënat e kërkuara gjatë seancës dëgjimore.

I. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

1. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të ankuesit.

Në bazë të dispozitave të ligjit nr. 80/2020 “Për Policinë e Burgjeve”, Policia e Burgjeve funksionon si strukturë administrative e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, që ndjek dhe realizon ruajtjen e rendit dhe të sigurisë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, si dhe gjatë transferimeve e shoqërimëve të të burgosurve në gjykata e institucione të tjera, në përputhje me ligjin, duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut.

Sipas parashikimit të nenit 11, pika 2 të ligjit të sipërcituar, struktura dhe organika e Policisë së Burgjeve miratohen si pjesë përbërëse e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, me urdhër të Kryeministrit, në bazë të propozimit të Ministrit të Drejtësisë. Pjesë e strukturës dhe e organikës së Policisë së Burgjeve, është edhe struktura e posaçme që ushtron funksionet përkatëse për garantimin e ruajtjes së rendit dhe të sigurisë në regjimin e posaçëm në institucionin e sigurisë së lartë.

Në referencë të nenit 28 të këtij ligji, marrëdhëniet e punës në Policinë e Burgjeve bazohen në parimet e mundësive të barabarta, të meritës, aftësive profesionale e mosdiskriminimit, si dhe pranimi në Policinë e Burgjeve kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës, transparent e të drejtë.

Mbështetur në nenin 31, pika 1, të ligjit nr. 80/2020 “Për Policinë e Burgjeve”, punonjësit e rolit bazë dhe të mesëm emërohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve mbi bazën e propozimit të drejtorit të Policisë së Burgjeve, sipas listës emërore të fituesve në rend zbritës.

Për sa i përket transferimit të punonjësve të Policisë së burgjeve, kjo çështje gjen rregullim në nenin 34, të këtij ligji, ku parashikohet shprehimisht:

1. *“Transferimi i punonjësit të Policisë së Burgjeve mund të bëhet nga drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, me propozimin me shkrim të drejtorit të Policisë së Burgjeve, vetëm për nevoja dhe në interes të punës.*
2. *Transferimi, si rregull, bëhet me pëlqimin e punonjësit.*
3. *Punonjësit e Policisë së Burgjeve të rolit bazë dhe të mesëm, që nuk japin pëlqimin për transferim, paraqiten në detyrë, por mund të ushtrojnë ankim në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative. Në çdo rast, afati i organit kompetent për t’u shprehur për ankimin nuk mund të jetë më i gjatë se 30 (tridhjetë) ditë.*
4. *Për punonjësit e rolit bazë transferimi lejohet deri në 45 kilometra larg vendbanimit.....”.*

Në nenin 3, pikat 10-11, të ligjit të sipërcituar përcaktohet se:

*“10. “Regjim i brendshëm” janë mjediset e banimit të të dënuarve dhe të paraburgosurve, mjediset e punës, mjediset e veprimtarive profesionale e kulturore dhe ato të përbashkëta.
11. “Regjim i jashtëm” është hapësira ndërmjet murit rrethues e rrethimit perimetrik, si dhe hapësira e sigurisë jashtë rrethimit perimetrik.”*

Sipas nenit 36 të ligjit, rolet në Policinë e Burgjeve pasqyrojnë nivelin e organizimit, të drejtimit, të kontrollit e të kryerjes së detyrave, si dhe tregojnë pozitën e punonjësve të Policisë së Burgjeve. Rolet ndahen në këto kategori: a) roli i lartë; b) roli i mesëm dhe c) roli bazë;

Për sa më sipër, ankuesi Y.R. është punonjës i Policisë së Burgjeve, që prej vitit 2015 punon pranë I.E.V.P. Berat, në pozicionin e rolit bazë. Ankuesi është emëruar në detyrë nëpërmjet Urdhërit nr. 5533/1, datë 15.06.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

Në vijim, nëpërmjet Urdhërit nr. 5610/1, datë 28.05.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve “Për transferim në detyrë të punonjësve të rolit bazë”, N/inspektori Y.R. dhe tre punonjës të tjerë të rolit bazë, përkatësisht N/inspektoria L.R., N/inspektor Sh. Sh. dhe

N/inspektor P.S. u transferuan në punonjës të rolit bazë pranë I.E.V.P. Fier. Transferimi i këtyre punonjësve u krye si pasojë e suprimimit të 4 pozicioneve të punës, pranë I.E.V.P. Berat, nëpërmjet strukturës së re organike të këtij institucioni të ekzekutimit të vendimeve penale. Mbështetur në Urdhërin e sipërcituar, ka dalë edhe Urdhëri nr. 2062 prot., datë 31.05.2021, i Drejtorit të I.E.V.P. Berat, nëpërmjet së cilit sërish përsëritet fakti i transferimit të punonjësve të sipërcituar pranë I.E.V.P. Fier, si dhe duke përcaktuar se marrëdhëniet administrative të tyre me I.E.V.P. Berat përfundojnë në datën 29.05.2021.

Për sa më sipër, mbështetur në dokumentacionin e depozituar në cilësi prove nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe I.E.V.P. Berat rezulton se është ndjekur një procedurë e caktuar nga këto institucione në vijim të daljes të Urdhërit nr. 43, datë 25.03.2021, të Kryeministrit, *“Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe sistemit të institucioneve në varësi të saj”*, nëpërmjet së cilit është miratuar organika e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe institucioneve në varësi të saj, ndër të cilat edhe I.E.V.P. Berat.

Kështu, në vijim të aktit të sipërcituar, Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve ka miratuar Urdhrin nr. 3512/1, datë 29.04.2021 *“Për zbatimin e Urdhërit të Kryeministrit për zbatimin e strukturës organike nr. 43, datë 25.03.2021”*, nëpërmjet së cilit është ngritur komisioni përkatës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për zbatimin e strukturës organike të miratuar me Urdhërin nr. 43/2021 të Kryeministrit. Këtij komisioni iu ngarkua detyra që të kryente shtrirjen organike sipas strukturës së miratuar, të hartonte listën e vendeve vakante, si dhe të bënte propozimet përkatëse për plotësimin e vendeve të cilat janë krijuar apo suprimuar.

Në vijim, pranë I.E.V.P. Berat u miratua Urdhëri nr. 1704, datë 04.05.2021, i Drejtorit të I.E.V.P. Berat *“Mbi ngritjen e komisionit për zbatimin e strukturës organike të I.E.V.P. Berat”*, nëpërmjet së cilit u ngrit komisioni për zbatimin e strukturës organike. Ky komision drejtohej nga Drejtori i I.E.V.P.-së dhe në cilësinë e anëtarëve bëjnë pjesë drejtues të tjerë të këtij institucioni, si përgjegjësi i burimeve njerëzore, përgjegjësi i Sektorit Ligjor, përgjegjësi i komanduar i çështjeve shoqërore dhe shefi i policisë. Detyra e Komisionit konsistonte në kryerjen e shtrirjes organike sipas strukturës së miratuar, hartimi i listës së vendeve vakante dhe kryerja e propozimeve për plotësimin e vendeve, të cilat janë krijuar apo suprimuar.

Në zbatim të detyrave respektive, komisioni hartoi shkresën nr. 874 prot., datë 11.05.2021, me lëndë: *“Relacion mbi zbatimin e Strukturës Organike nr. 43, datë 25.03.2021”* drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Sipas këtij Relacioni rezulton se pranë I.E.V.P. Berat suprimohen disa pozicione pune, përkatësisht: pozicioni i Përgjegjës të Sektorit të Logjistikës, pozicioni Specialist Psikolog, në sektorin e Çështjeve Shoqërore, 2 pozicione pune në Regjimin e Brendshëm dhe 2 pozicione pune në Regjimin e Jashtëm. Në këtë Relacion përcaktohet gjithashtu si vijon: *“Duke qenë se në organikën e stafit të Policisë suprimohen 4 (katër) vende pune, komisioni për zbatimin e*

strukturës organike të I.E.V.P. Berat, duke u bazuar në një sërë kriteresh si vendbanimi i punonjësve, vlerësimi i tyre në punë, vendosi të propozojë:

1.Transferimin e N/Inspektore L.R., N/Inspektor P.S., N/Inspektor Y.R., N/Inspektor Sh.Sh. nga I.E.V.P. Berat në I.E.V.P. Fier.”

Sikurse rezulton nga përmbajtja e aktit të sipërcituar, nga analiza e strukturës organike që ka kryer Komisioni i ngritur pranë I.E.V.P. Berat ka rezultuar se në I.E.V.P. Berat ishin shkurtuar 4 pozicione pune për punonjësit e rolit bazë, konkretisht 2 pozicione në Regjimin e Jashtëm dhe 2 pozicione në Regjimin e Brendshëm. Në kushtet kur, në I.E.V.P. Fier ekzistonin vende vakante për punonjësit e rolit bazë, u mendua që këta 4 punonjës të transferoheshin në këtë institucion

Në vijim, Komisioni i ngritur pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve hartoi aktin Memo nr. 3512/7, datë 27.05.2021, nëpërmjet së cilit pasqyrohen ndryshimet përkatëse në I.E.V.P.-të në varësi të këtij institucioni dhe struktura të tjera. Referuar Memos ne fjalë rezulton se në organikën e I.E.V.P. Berat janë suprimuar 4 pozicione pune të rolit bazë të cilët janë propozuar për t'u transferuar në I.E.V.P. Fier.

Mbështetur në sa më sipër, si dhe në bazë të shkresës nr. 5610 prot., datë 28.05.2021 të Drejtorit të Policisë së Burgjeve, me lëndë: *“Propozim për transferim në detyrë të punonjësve të rolit bazë”*, Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve u shpreh me Urdhërin nr. 5610/1, datë 28.05.2021, *“Për transferim në detyrë të punonjësve të rolit bazë”*, nëpërmjet së cilit të katër punonjësit e rolit bazë që u ishte shkurtuar pozicioni i punës, u transferuan pranë I.E.V.P. Fier.

Lidhur me çështjen objekt ankese të ankuesit Y.R., Komisioneri u fokusua edhe tek procedura e ndjekur për përzgjedhjen e punonjësve të rolit bazë që u transferuan në I.E.V.P. Fier dhe kriteret që u morën parasysh për transferimin e tyre.

Në korrespondencën zyrtare që KMD pati me I.E.V.P. Berat, rezulton se fillimisht të gjithë punonjësit e Regjimit të Jashtëm dhe Regjimit të Brendshëm u informuan për shkurtimin e 4 pozicioneve të punës dhe iu kërkua se kush shprehte dëshirën për t'u transferuar në I.E.V.P. Fier. Përveç punonjësës L.R., që ishte në Regjimin e Jashtëm, asnjë punonjës tjetër nuk dëshironte të transferohej pranë I.E.V.P. Fier.

Në këto kushte, ishte detyrë e Komisionit, përzgjedhja e tre punonjësve të tjerë që do të transferoheshin në I.E.V.P. Fier, përkatësisht 1 punonjës nga Regjimi i Jashtëm dhe 2 punonjës nga Regjimi i Brendshëm.

Sikurse është përmendur edhe më sipër, në nenin 34 të ligjit nr. 80/2020 *“Për Policinë e Burgjeve”* është parashikuar se transferimi mund të bëhet nga Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, me propozim të Drejtorit të Policisë së Burgjeve, vetëm për nevoja dhe në interes të punës dhe transferimi bëhet si rregull, me pëlqimin e punonjësit dhe nuk lejohet transferimi për punonjësit e

rolit bazë mbi 45 km nga vendbanimi. Në këtë kontekst, KMD konstatoi se i vetmi kriter ligjor për transferimin e punonjësve të Policisë së Burgjeve është që largësia e vendbanimit me I.E.V.P.-në përkatëse nuk duhet të jetë mbi 45 km.

Në shkresën nr. 874 prot., datë 11.05.2021, me lëndë: “*Relacion mbi zbatimin e Strukturës Organike nr. 43, datë 25.03.2021*” drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, I.E.V.P. Berat ka informuar institucionin epror se për përzgjedhjen e punonjësve, që do të transferoheshin për në I.E.V.P. Fier, përveç kriterit ligjor të sipërcituar, ka ndjekur edhe kriterin e vlerësimit të tyre në punë.

Njëkohësisht, në shkresën nr. 2193 prot., datë 05.11.2021, të I.E.V.P. Berat drejtuar KMD-së, është cituar se kriteret përzgjedhëse për këta punonjës kanë qenë largësia e vendbanimit, performanca në punë dhe kriteret e veçanta. Për sa më sipër, rezulton se kriteri i performancës në punë dhe kriteret e veçanta janë vendosur nga vetë Komisioni i Ristrukturimit, për të kryer përzgjedhjen e punonjësve.

Për sa më sipër, rezulton se deri në momentin e hyrjes në fuqi të urdhërit të Kryeministrit nr.43, datë 25.03.2021, në I.E.V.P. Penale Berat kanë punuar 106 punonjës të rolit bazë, të ndarë sipas sektorëve përkatës, si vijojnë:

- 23 punonjës të emëruar në Grupin e Sigurisë dhe Shoqërimeve,
- 45 punonjës të emëruar në Regjimin e Brendshëm dhe,
- 38 punonjës të emëruar në Regjimin e Jashtëm.

Në bazë të strukturës së miratuar për I.E.V.P. Berat rezulton se Grupi i Sigurisë dhe Shoqërimeve nuk ndryshonte numrin e punonjësve, ndërsa Regjimi i Brendshëm nga 45 punonjës bëhej me 43 të tillë dhe Regjimi i Jashtëm nga 38 punonjës bëhej me 36 të tillë.

Në procesin e shqyrtimit të kandidaturave, Komisioni përjashtoi fillimisht punonjësit e rolit bazë me vendbanim mbi 45 km nga I.E.V.P. Fier.

Për sa më sipër, Y.R. ishte punonjës në Regjimin e Brendshëm. Në këtë Regjim rezultuan se vetëm 11 punonjës e kishin vendbanimin e tyre nën 45 km largësi nga I.E.V.P. Fier. Në këtë kontekst, secili prej tyre mund të transferohej dhe për këtë arsye u bë një përzgjedhje e tyre.

Ndërkohë që, në Regjimin e Jashtëm, u përzgjedh vetëm një punonjës për t’u transferuar, përkatësisht punonjësi Sh.Sh. (me distancë 40 km), në kushtet kur, punonjësja L.R., që ishte ishte pjesë e tij, kishte kërkuar vetë të transferohej pranë I.E.V.P. Fier.

Mbështetur në të dhënat e punonjësve të rolit bazë të dërguara nga I.E.V.P. Berat rezulton se punonjësit, që plotësonin kriterin ligjor për t’u transferuar, atë të largësisë së vendbanimit nën 45 km nga I.E.V.P. Fier, janë si më poshtë vijojnë:

Regjimi i Brendshëm i I.E.V.P. Berat					
Nr.	Emër, mbiemër	Largësia e vendbanimit nga I.E.V.P. Fier (km)	Vlerësimi në punë	Masa disiplinore	Arsye të veçanta
1.	D.H.	33 km	70 pikë	ska	mosha 63 vjeç
2.	G.Z.	26 km	61 pikë	3 vërejtje me paralajmërim	fëmijë i mitur autik
3.	B.M.	40 km	52 pikë	vërejtje, vërejtje me paralajmërim	disa herë i transferuar
4.	R.Q.	31 km	70 pikë	vërejtje, vërejtje me paralajmërim	piket
5.	Y.R.	40 km	65 pikë	vërejtje, vërejtje me paralajmërim	
6.	M.M.	40 km	70 pikë	ska	pikët
7.	R.M.	42 km	70 pikë	vërejtje me paralajmërim	pikët
8.	P.C.	25 km	65 km	vërejtje	mosha mbi 60 vjeç
9.	A.A.	33 km	70 km	ska	pikët
10.	A.H.	26 km	80 km	ska	pikët
11.	P.S.	42 km	65 pikë	vërejtje	

Komisioni përzgjedhi për transferim drejt I.E.V.P. Fier, punonjësit P.S. (me distancë 42 km) dhe Y.R. (me distancë 40 km) nga Regjimi i Brendshëm.

Në shkresën e I.E.V.P. Berat sqarohet se të ndodhur para faktit që duhej të përzgjidheshin 3 kandidatura për transferim dhe përveç kriterit ndalues nuk kishte asnjë kriter tjetër, ku të bazoheshin, Komisioni i ristrukturimit vlerësoi bashkërisht distancën nga vendbanimi, performancën në punë dhe arsyet e veçanta, që kishin të bënin me moshën, me gjendjen familjare, me faktin që një punonjës ishte transferuar disa herë më parë etj. Në shkresën nr. 8459/3, datë 24.08.2021, e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, veç kriterëve të sipërcituara është përmendur edhe se është marrë në shqyrtim edhe nëse ndaj punonjësve janë marrë masa disiplinore.

Bazuar në të dhënat e tabelës së mësipërme, KMD konstaton se në zbatim të kriterit ligjor ndalues për kryerjen e transferimit, 11 punonjës të regjimit të brendshëm pranë I.E.V.P. Berat mund të transferoheshin pranë I.E.V.P. Fier.

Nga tabela e mësipërme për tre punonjës është aplikuar kriteri i arsyeve të veçanta, që sipas Komisionit të ristrukturimit, janë: mosha mbi 60 vjeç – për z. D.H. dhe P.C., si dhe pasja e një fëmijë që vuan nga autizmi – punonjës in G.Z. Ndërsa për z. B.M., vendbanimi i së cilit është 40 km (sikurse ankuesi) nga I.E.V.P. Fier, pavarësisht performancës me pikavarazh më të ulët se ankuesi, nuk është kryer transferim, pasi rezulton se është transferuar herë të tjera.

Për sa më sipër, KMD bie dakord në parim me llogjikën vlerësuese të Komisionit të Ristrukturimit të I.E.V.P. Berat, për sa i përket arsyeve të veçanta, që disa punonjës mund të kenë patur të tilla si: mosha apo sëmundje të fëmijëve të tyre, të cilat janë realisht arsye, të cilat çdo punëdhënës duhet t'i marrë parasysh në raste të tilla. Këto konsiderohen masa pozitive ndaj atyre punonjësve që plotësojnë kritere sikurse ato të sipërcituara.

Komisioneri gjykon se ankuesi dhe punonjësi P.S. plotësojnë kriterin ligjor të largësisë së vendbanimit (nën 45 km) nga I.E.V.P. Fier dhe si të tillë janë transferuar konform parashikimit ligjor, duke marrë parasysh edhe kriteret e tjera të vendosura nga Komisioni i Ristrukturimit pranë I.E.V.P. Berat.

Për sa më sipër, KMD gjykon se z. Y.R. nuk është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues nga ana e I.E.V.P. Berat dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 1, nenin 7, pikat 1 dhe 3, nenit 12, nenit 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-12, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të z. Y.R., për shkak të etnisë, nga nga ana e I.E.V.P. Berat.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Fusha – Punësim
Shkak – etnia
Lloji i vendimit - mosdiskriminim